


MENDIMI YT VLEN



DEMOKRACIA DHE QYTETARËT AKTIV

NARTI (10), DENISI (10), EDRINI (10), ARDI (10), ALDINA (10), LEONORA (10)

Liria, toleranca, barazia dhe respekti i qytetarëve aktiv në Republikën e Kosovës Demokratike

Demokracia nënkupton rendin e popullit. Ka dy lloje të demokracisë, ato janë demokracia e drejtpërdrejtë dhe ajo përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese ndahet në dy sisteme: sistemi presidencial dhe ai parlamentar. Populli i zgjedh përfaqësuesit e tyre me anë të votave. Në demokraci elementet kryesore janë: toleranca, respekti, të drejtat e barabarta dhe liria. Në demokraci kemi shumë të drejta. Ne kemi të drejtën e shkollimit, e lojës, e punës, e strehimit, e familjes, etj. Qytetarët aktiv janë ata njerëz të cilët ruajnë ambientin dhe ndihmojnë njëri-tjetrin. Përgjegjësitë tona si qytetarë janë të mos shkelim rregullat, t'i ndihmojmë të mos-huarit, etj.



Gazetarët e artikullit



A mund të bashkëpunojmë?

Bashkëpunimi ka rëndësi




A mund t'iu ndihmoj?

Të ndihmojmë të tjerët është gjë e mirë




Duhet të jemi të përgjegjshëm



Disa elemente të demokracisë

INSTITUCIONI MË I LARTË LEGJISLATIV

ROMIR (10), ERDETA (10), ANIL (10), GALDIM (10), AGON (11), ENIS (10), REA (10)



Ç'është Kuvendi i Kosovës dhe si funksionon ky institucion?

Nxënësit e shkollës „Faik Konica“ dëshirojnë të iu tregojnë për Kuvendin e Kosovës. Kuvendi i Kosovës është një institucion demokratik, ku punojnë deputetët. Ne mësuam se Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë, 100 prej tyre janë nga qytetarët shumicë, ndërsa 20 prej tyre janë qytetarë të komuniteteve jo shumicë. Ato janë: komunitetet RAE që janë romë, ashkalinjë dhe egjiptian, komuniteti serb, boshnjak dhe turk. Deputetët ndahen në pozitë dhe opozitë. Pozita përbëhet nga partia e cila ka fituar shumicën e votave në zgjedhjet e fundit. Kurse opozita përbëhet nga partitë që kanë fituar më pak vota. Pozita ulët në mes të sallës, ndërsa opozita ulët anash. Gjatë ditës së sotme, ne kuptuam se Kuvendi i Kosovës i miraton ligjet që vijnë nga Qeveria. Pasi deputetët i përshtatin ato në Kushte-

tutën e Kosovës, Qeveria i ekzekuton. Kryeministri dhe ministrat e Qeverisë ulen përballë deputetëve, sepse ata iu përgjigjen pyetjeve të deputetëve dhe i japin llogari Kuvendit të Kosovës. Ligjet propozohen nga qeveria, deputetët, Presidenti dhe 10 mijë qytetarë. Ky institucion ka tri funksione. Funksionin përfaqësues, sepse Kuvendi përfaqëson popullin e vet; funksionin legjislativ, sepse Kuvendi miraton dhe nxjerr ligje; dhe funksionin i tretë është funksioni kontrollues, sepse Kuvendi i Kosovës kontrollon Qeverinë nëse ajo e bën punën e saj siç duhet. Kuvendi i Kosovës gjithashtu punon me komisionet e ndryshme. Ne mendojmë se Kuvendi është institucion shumë i fuqishëm dhe me rëndësi për demokracinë tonë.

Kur punon Kuvendi ashtu si duhet, gjithë vendi punon si duhet dhe të gjithë ne, qytetarët jemi të lumtur duke jetuar në Kosovë.



Ne, grupi i „Rrushave“



Balonat e Kuvendit të Kosovës

ASAMBLEISTËT E RINJË

ARBËR (10), ELION (10), ELIZA (10), ENSAR (10), LUM (10), RRYTA (10), JONI (10)


Ne sot mësuam për zgjedhjet në përgjithësi, duke përfshirë këtu nocionin e zgjedhjeve si dhe llojet e zgjedhjeve. Ne më shumë u fokusuam tek zgjedhjet lokale (komunale)

Ne si fëmijë çdo ditë ndeshemi me zgjedhje, por këto zgjedhje nuk janë të njëjta me zgjedhjet që ne sot i mësuam. Pra, zgjedhjet qenkan forma më demokratike që disa individë apo parti tentojnë të vihen në pushtet, ku populli është ai që vendos se kush duhet të jetë përfaqësues i vendit.

Dallimi mes tyre është se zgjedhjet tona që ne si fëmijë i bëjmë në mënyrë individuale dhe që shërbejnë vetëm për ne. Ndërsa, zgjedhjet komunale ndryshe nga zgjedhjet tona kanë të tjera detyra dhe përgjegjësi. Në zgjedhjet lokale (komunale) kandidojnë anëtarë të partive të ndryshme që i përkasin asaj komune. Pra, në zgjedhjet komunale zgjedhet kryetari i komunës si

dhe asambleistët që po ashtu janë qytetarë të asaj komune.

Mandati si i kryetarit të komunës, po ashtu edhe i asambleistëve është 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Pasi i mësum këto lloje zgjedhesh ne si fëmijë shprehëm dëshirën t'i praktikojmë zgjedhjet komunale. Në total ishim gjithsej 7 parti, 2 për kryetar komune dhe 5 kandiduam për asambleistë. Secili prej kandidatëve u mundua në një mënyrë apo tjetrën t'i bind qytetarët (nxënësit e tjerë) që të na votojnë. Pasi përfundoi e tërë fushata erdhi koha edhe e votimeve. Vota ishte e fshehtë, dhe secili nga ne e votuam atë që menduam se ishte më i miri.



Në këtë punim tregohet më shumë rreth llojeve të zgjedhjeve



Disa nga asambleistët duke shkruar programin e tyre



Ne jemi asambleistët e rinjë

NDARJA E PUSHTETIT

DORJAN (10), BERSANT (10), ARI (10), JON (10), ENDI (10), NESA (10), EDINA (10), PELLAZG (9)



Ndarja e pushtetit në Republikën e Kosovës

Në ndarjen e pushtetit bëjnë pjesë tri pushtete. Ndarja e pushtetit bëhet për arsye se secili pushtet duhet të punoj në mënyrë të pavarur dhe me këtë ndarje të pushtetit, vendi ynë funksionon mirë. Detyrë e këtyre ndarjeve është t'i trajtoj të gjithë të barabartë pa dallim të gjinisë, fesë, apo racës. Pushteti i parë është Pushteti Legjislativ. Në Pushtetin Legjislativ bën pjesë Kuvendi. Kuvendi bën propozimin dhe miratimin e ligjeve. Aty diskutohen çështje të ndryshme për jetën tonë, për shembull, vendimet që merren në edukim dhe shëndetësi na ndihmojnë neve nxënësve më së shumti. Një ligj i ri që merret për arsim ka ndikim tek të gjithë nxënësit, dhe të gjithë ne përfitojmë nga këto ligje.

Pushteti i dytë është Pushteti Ekzekutiv. Në këtë Pushtet bën pjesë Qeveria, e cila mund të propozoj projektligje, të cilat me anë të votimit bëhen ligje dhe i ekzekuton ato. Kuvendi e mbikëqyr Qeverinë.

Pushteti i tretë është Pushteti Gjyqësor në të cilin bëjnë pjesë Gjykatat. Roli i gjykatave është ta mbajnë drejtësinë e vendit tonë. Pra gjykata shikon se apo e thyen dikush ligjin.

Trajtimi i barabartë për të gjithë është demokraci. Në demokraci bën pjesë edhe dalja në zgjedhjet e vendit. Ne i zgjedhim përfaqësuesit tonë me vota. Edhe ne mund të japim kontribute të ndryshme për shtetin tonë. Për shembull, ne mund të votojmë mbi moshën

18 vjeçare, ne mund të jemi tolerant, ta respektojmë njëri-tjetrin, të jemi të edukuar dhe të sjellshëm, si dhe ta shprehim mendimin tonë lirshëm.



Kuvendi i Republikës së Kosovës



Nxënësit e klasës V-2 mësojnë për ndarjen e pushtetit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Faik Konica“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë